



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 26 dhjetor 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1213_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 8 Paragrafët 4, 8 dhe 11 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 30.10.2019 për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit: Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2020;

në seancën e mbajtur me datë 26 dhjetor 2019, nxori këtë:

VENDIM

I. MIRATOHET dokumenti Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2020

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 30 tetor 2019 ka pranuar kërkesën për aprovim të dokumentit **Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2020** nga KOSTT Sh.A. ZRRE ka dhënë komentet e veta në formë të shkruar dhe përmes komunikimeve tjera të cilat komente janë përfshirë, apo çështjet e ngritura janë sqaruar. Pas përfshirjes së komenteve, dokumenti është dërguar në ZRRE si version final për aprovim me datë 10 dhjetor 2019.
 - Bazuar në Nenin 8 të Ligjit për Energjinë, pas analizimit të dokumentit përfundimtar, ZRRE konsideron se dokumenti i përmbush kriteret për miratim, dhe duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje të vendimit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi duke miratuar dokumentin **Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2020**.
- II. Në zbatim të nenit 42, paragrafi 2.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Zyra e Rregullatorit për Energji do të monitoroj implementimin e Bilancit Vjetor të Energjisë elektrike për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në Bilanc.
- III. Bilanci do të publikohet në faqen zyrtare të ZRRE-së si dokument unik i ZRRE së bashku me Bilancin e energjisë termike 2020.



- IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet si një dokumenti i përbashkët si **Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike dhe Energjisë Termike**.

Këshillë juridike: Palët e pakënaqura me këtë Vendim mund të iniciojnë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

- **Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2020**

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së,



Arsim Janova, u.d. Kryesues



Besim Sejfiqaj, anëtar



Selman Hoti, anëtar



Izet Rushiti, anëtar